



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.559/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Burim Gërguri, Sekretar për Degë - Shtabi Zgjedhor, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Burim Gërguri, Sekretar për Degë - Shtabi Zgjedhor, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 01.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Burim Gërguri, Sekretar për Degë-Shtabi Zgjedhor, nga radhët e subjektit politik AAK, me të cilën thekson se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave, andaj kërkon rinumërimin e votave në dy vendvotime, si në: Plemetin 1512E/02D, Babimost 1507R/01D, për shkak të rezultatit të ngushtë i cili ka lënë në balotazh kandidatin e AAK-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesë, të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes së ankesës vlerësoj se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj.

Paneli vlerësoj se ankesa e parashtruar nga parashtruesi i ankesës nuk i plotësojë këto standarde ligjore. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me parregullsitë e paraqitura në ditën e votimit më tej vendvotimet e lartë cekura, ashtu si është përcaktuar në nenin 5.7 pika b) dhe c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-së nr.02/2015, ku përcaktohet: ”Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku këto informacione: një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën kohën dhe vendin

e shkeljes së pretenduar; hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit”.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.559/2017 më datën 02.11.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zynda Haziri**

***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*